

DEKLARATË E PËRBASHKËT që u atribuohet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkimit Evropian (BE)

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë dhe Bashkimi Evropian (BE) i kanë përcjelle me vemendje shqetësimet pas njoftimit për restaurimin e një lokacioni të trashëgimisë kulturore në Mitrovicë që lidhet me pronarin e mëparshëm Xhafer Deva, e kaluara e të cilit si bashkëpunëtor i nazistëve është komentuar shumë gjatë ditëve të fundit.

Synimi i projektit ka qenë gjithmonë të bashkojë komunitetet dhe të kontribuojë në kohezionin social duke përdorur trashëgiminë kulturore si instrument për dialog ndërkomunitar dhe duke rivendosur trashëgiminë kulturore në shfrytëzim të komuniteteve. UNDP dhe Bashkimi Evropian shprehin keqardhje të sinqerte për çdo ofendim të paqëllimshëm të shkaktuar përmes njoftimit për fillimin e punimeve por duke mos e cekur sfondin historik të Xhafer Devës.

UNDP dhe BE dënojnë fuqishëm antisemitizmin dhe ksenofobinë dhe manifestimet e tyre të shumta, duke përfshirë rritjen e intolerancës dhe fanatizmit ndaj pakicave etnike dhe komuniteteve të cënueshme. Ne jemi të përkushtuar të mbrojmë të pambrojturit, të promovojmë të drejtat themelore të njeriut dhe të mbështesim lirinë, dinjitetin, dhe të luftojmë dezinformimin.

UNDP së bashku me BE-në, kanë pezulluar punën në lokacion. Ne jemi në kontakt me të gjitha palët e përfshira dhe po e rivlerësojmë rolin dhe kontributin tonë, duke përfshirë mundësinë e shfrytëzimit të polemikës aktuale si mundësi për të shqyrtuarhaptazi të kaluarën përmes diskutimeve dhe konsultimeve me të gjitha komunitetet përkatëse.

Projektet e trashëgimisë kulturore të zbatuara nga UNDP që nga viti 2016, në partneritet me BE-në, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, komunitat dhe komunitetet fetare, kanë rinovuar dhe rehabilituar më shumë se 35 objekte kulturore dhe fetare, që u përkasin grupeve të ndryshme fetare dhe etnike që jetojnë në Kosovë. Projektet janë fokusuar gjithashtu në rigjallërimin e trashëgimisë kulturore shpirtërore në formën e artit, muzikës dhe aftësive artizanale, dhe kanë organizuar një sërë kurse dhe trajnime, si dhe kampe restaurimi, të fokusuara veçanërisht te gratë dhe të rinjtë nga komunitete të ndryshme. Të gjitha ndërhyrjet kontribuojnë në forcimin e besimit dhe kohezionit social si dhe në rritjen e respektit për trashëgiminë e përbashkët kulturore të komuniteteve dhe feve të ndryshme në mbarë Kosovën